



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 2 datë 5.1.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 1, DATË 22.1.2016 “PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 5.1.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, pika 1.3. shkronja “a”, “b”, nenit 23, nenit 35, pika 5, shkronja “a”, nenit 54 shkronja “f”, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 14, nenit 18, të Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligjit nr. 71/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM-në nr 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”; VKB nr.18 datë 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi “Sport dhe Argëtim”, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të Klubit Sportiv “Vllaznia”; VKM Nr.607, datë 29.7.2020 “Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 15,16 18,19 të Ligjit nr.24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”; nenit 36 të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”; nenit 3, pika 24 të Ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar; VKM Nr.418 datë 27.05.2020 “Miratimi i politikave strategjike dhe të planit kombëtar të mbetjeve 2020-2035”; Ligjit nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar; Ligjit Nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për

planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar dhe sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë së Shkodrës, sipas dokumentit bashkëngjitur “Paketa Fiskale Bashkia e Shkodrës (e përditësuar)”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

  
**Brisela KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
**Denis Lasha**

Miratuar me 32 vota  
Vota Pro 32  
Vota Kunder 0  
Vota Abstenim 3  
Zbardhur me datë 10.1.2022